REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:288457
Datë: 12.03.2021
Numri i dokumentit: 01589880

A.nr.2956 /19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Arjeta Sadiku dhe me procesmbajtësen Nazmije Beka, në konfliktin administrativ të paditësit, R. H., nga Gj., Rr. "..." Lagja Z. nr.., kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me bazë juridike anulim i aktit administrativ, jashtë seancës, me datën 1 mars 2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit R. H., me adresë në nga Gj., Rr. "..." Lagja Z. nr.., **si e bazuar**.

II. **ANULOHET** akti administrativ (njoftimi) i të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) Nr.ref.A.nr.592/2019 i datës 12.11.2019 dhe detyrohet e paditura që në afat prej tridhjetë (30) ditësh me vendim të vendosë lidhur me ankesën e paditësit të datës 30.09.2019 dhe të njëjtin t'ia dorëzojë palëve sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

A r s y e t i m

Paditësi, R. H. nga Gj., ka ushtruar padi në këtë gjykatë më datën 11.12.2019, kundër të paditurës, KPMSHCK në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ Nr.ref.A.nr.592/2019 të datës 12.11.2019.

2019:288458

Gjykata shqyrtoi aktin administrativ të goditur me padi në përputhje me nenin 35 Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se:

"Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigjen".

Po ashtu edhe në bazë të nenit 44.2 të njëjtit ligj i cili përcakton se:

"Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare".

Nga akti administrativ i kundërshtuar, gjykata vëren se e paditura për shkak të rrethanave të cilat kanë pamundësuar nxjerrjen e vendimit siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke iu përgjigjur ankesës së paditësit, ka lëshuar njoftimin Nr.ref.A.nr.592/2019 i datës 12.11.2019. Paditësi i pakënaqur me këtë akt administrativ ka parashtruar padi në këtë gjykatë, duke kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata shqyrtoi kërkesëpadinë e paditësit dhe vlerësoi se në raport me këtë akt administrativ konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimi i këshillit paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe i njëjti është i ekzekutueshëm.

Duke marr parasysh faktin se tani kanë pushuar shkaqet të cilat kanë pamundësuar të paditurën për vendosjen e çështjes dhe duke marr parasysh se çështja e vendosjes nga ana e të paditurës përbën çështje paraprake për vendosje në mënyrë meritore sipas padisë së paditësit, gjykata vendosi që çështjen ta kthejë tek e paditura për vendosje sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të metat e cekura më lartë, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kundërshtuar, ndërsa rrethanat e reja tek e paditura mundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës administrative, në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit

2019:288458

65 të Ligjit për Konflikte Administrative, që në afat prej 30 ditësh, në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë, e të bazuar në ligj, me të cilin do të njoftohen palët me kohë.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të neneve 5, 35, lidhur me nenin 44.2, dhe 46 par. 3 i Ligjit për konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.2956/19, datë 1 mars 2021

Sekretarja Juridike **G j y q t a r j a**
Nazmije Beka **Arjeta Sadiku**

KESHILLA JURIDIKE*: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.*

2019:288458